



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 105, Datë 10.07.2017

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “AYEN AS ENERGY” SH.A., PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË “PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE” ME NR. 273, SERIA PV15K, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 32, DATË 04.03.2015

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; VKM nr. 365, datë 04.05.2011 “Marrëveshje Kocensionare me nr. 5446 Rep; nr. 1944 Kol, datë 02.05.2011”, të ndryshuar; nenit 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 109, datë 29.06.2016; neni 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.07.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për modifikimin e licencës së shoqërisë “Ayen As Energy” sh.a., përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

Konstatoi se:

- Shoqëria “AYEN AS ENERGY” sh.a., është licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Gojan”, “Gjegjan”, “Peshqesh” dhe “Fangu” me fuqi totale të instaluar 110.54 MW, me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 32, datë 04.03.2015.
- Shoqëria “Ayen As Energy” sh.a, ka nënshkruar një Kontratë shtesë të Koncesionit me nr. 217 Rep., Nr. 68/1 Kol., datë 20 Janar 2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT” Kontratës Koncesionare nr. 5446 REP., Nr. 1944 KOL., datë. 02.05.2011; ndryshuar për sa vijon “Të zbatojë projektin për ndërtimin e hidrocentraleve të Peshqeshit, Ura e Fanit, Fangut, me një fuqi totale 109.71 MW.”
- Dokumentacioni i depozituar në ERE nga shoqëria “Ayen As Energy” sh.a., në bazë të “Rregullores për Procedurat e Licencimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/të Pjesshëm dhe Rinovimit të Licencave”, rezulton si më poshtë:
- Neni 9, pika 1: gërma “a” (të dhënat për aplikim), gërma “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit) dhe gërma “c” (të dhëna për aplikuesin) pa plotësuar.
- Neni 15 pika 4, gërma “a”, një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës; plotësuar.
- Gërma “b”, vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licensuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës; pa plotësuar.
- Gërma “c” miratimin e modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera; plotësuar.
- Gërma “d” ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licensuarit sipas legjislacionit në fuqi; Plotësuar.
- Gërma “e” Të ketë kryer pagesat e rregullimit në ERE, plotësuar.

- Nga HEC-et “Gojan”, “Gjegjan”, “Peshqesh” dhe “Fangu” të dhëna me koncesion subjektit “Ayen AS Energy”, janë hequr HEC-et : “Gojan” dhe “Gjegjan” dhe është shtuar HEC – i i ri “Ura Fanit.”
- Ka ndryshuar fuqia e instaluar e HEC-eve të dhëna me koncesion më herët e për të cilët ERE është shprehur me vendim.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë “Ayen As Energy” sh.a., dhënë me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 32 datë 04.03.2015, me nr. 273, Seria PV15K për Prodhimin e Energjise Elektrike nga Hec-et e “Gojanit”, “Gjegjanit”, ”Peshqesh”, “Ura e Fanit” dhe “Fangu”, me fuqi totale 110.54 MW, në përputhje me parashikimet e kontratës shtesë të koncesionit me nr. 217 Rep., nr. 68/1 Kol., datë 20 Janar 2017, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT” Kontratës Koncesionare nr. 5446 REP., Nr. 1944 KOL., datë. 02.05.2011.*
2. Ngarkohet Drejtorja e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari

Petrit AHMETI